

VENDIM
Nr.607, datë 12.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VORË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vorë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Vorë, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.502, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në bashkinë Vorë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Vorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vorë	Lidhje 1
Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës
2-13	Lloji i transferimit
14-17	Në pronësi
18, 37, 193-197, 500-521	Në pronësi
20-31	Në pronësi
38-54	Në pronësi
19	Në pronësi
56, 59-73, 79, 106-192	Në përdorim
55, 57, 58, 74-78, 80-105, 198-262	Në pronësi
446, 450, 452, 456, 459, 462, 464, 468, 473, 491-499	Në pronësi
443-445, 447-449, 451, 453-455, 457, 458, 460-461, 463, 465-467, 469-472	Në përdorim

